



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 1183 prot.

Tiranë, më 06.08.2021

V E N D I M

Nr. 146, datë 06.08.2021

Mbështetur në nenin 32, pika 1, gërma a), të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi po shqyrton ankesën ankesën nr. 19, datë 19.02.2021, të K. M.¹ dhe Shoqatës “Shpresë për të verbërit”, ku pretendohet diskriminim për shkak të “aftësisë së kufizuar”, nga ana e Shoqërisë Shpresa-AL sh.p.k.

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Shoqata “Shpresë për të verbërit”, në ankesën e paraqitur pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka sqaruar se: *“Unë K. M. me cilësinë e personit me aftësi të kufizuar (e verbër), me dt. 09.02.2021, ora 13:30, kam hipur në autobuzin e linjës Tiranë- Kamëz me targa AA 987 YZ të Shoqërisë “Shpresa AL”. Kam qënë e shoqëruar me presidentin e Shoqatës dhe shoqëruesen e tij, znj. F. Fatorinos i paraqita librezën e verbërisë, ai me tha në linjën tonë nuk njihet kjo librezë dhe na e mori nga duart. Në debat e sipër ai tha “Ne njohim vetëm librezat e lëshuara nga A. O. (Kryetar i Shoqatës së Invalidëve të Punës). Më detyroi të paguaj biletën me nr. serie 28/20, nr. 0975635 duke mos e njohur librezën e verbërisë. Librezën që më mori fatorino e çoi tek dispeceri ku dhe ata mbajtën të njëjtin qëndrim, për këtë arsye u detyruam të bëjmë kallëzim në Komisaratin e Policisë Kamëz.*

Pas kallëzimit në polici e njëjta gjë ka ndodhur me presidentin e Shoqatës “Shpresë për të verbërit” gjatë kthimit për në Tiranë me të njëjtën linjë. Sjellja e tyre me bën të ndihem e diskriminuar, në të njëjtën situatë janë dhe të verbërit e tjerë që përdorin këtë linjë. Mos respektimi i nenit 11, të ligjit nr. 8098, datë 28.03.1996 “Për statusin e të verbërit” dhe pretendimi i përfaqësuesve të Shoqërisë Shpresa-AL, se marrim kompesim dhe dhënia e kësaj të drejte vetëm për invalidët e punës, kjo për ne është diskriminim dhe përjashtim nga një e drejtë legjitime e të verbërve.”

¹ Përfaqësuar me Autorizim nga ana e Shoqatës “Shpresë për të verbërit”, lidhur me situatën e ndodhur me Shoqërinë “Shpresa-AL”

Mbështetur në nenin 33, pika 2 e Ligjit Nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, ku citohet se: “Organizata me interesa legjitime mund të kërkojnë kryerjen e hetimeve administrative nëpërmjet disponimit të informacionit të besueshëm, si dhe të përfaqësojnë një person ose grup personash, pasi të jetë marrë pëlqimi me shkrim ose të mbahet procesverbal në prani të një punonjësi të institucionit, për të përfaqësuar personin ose grupin e personave”, Shoqata “Shpresë për të verbërit”², përfaqëson pranë KMD-së, K. M. dhe grupin e personave të verbër të cilët pretendohet se diskriminohen, si rezultat i moszbatimit të ligjit nr. 8098, datë 28.03.1996 “Për statusin e të verbërit”, të ndryshuar.

Sipas përfaqësuesve të Shoqatës “Shpresë për të verbërit”, nga ana e punonjësve të Shoqërisë së Transportit Shpresa-AL sh.p.k, i është thënë se ligji nr. 8098, datë 28.03.1996 “Për statusin e të verbërit”, ka ndryshuar që në vitin 2012 dhe me ndryshimet e bëra tashmë të verbërit përfitojnë kompensim dhe nuk mund të udhëtojnë falas në transportin qytetas.

Në përfundim të ankesës së sipërcituar, Shoqata “Shpresë për të verbërit”, pretendon se është diskriminuar nga ana e përfaqësuesve të Shoqërisë së Transportit Shpresa-AL sh.p.k., duke mos i njohur Librezën e lëshuar nga ana e Shoqatës së tyre, por vetëm librezën e lëshuar nga Shoqata e Invalidëve të Punës, si dhe duke mos zbatuar ligjin nr. 8098, datë 28.03.1996 “Për statusin e të verbërit”.

Në këtë kuptim, Shoqata “Shpresë për të verbërit”, kërkon nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, të konstatojë:

1. Diskriminimin e personave të verbër nga ana e Shoqërive të Transportit në të gjithë Shqipërinë.
2. Të hetojë pretendimin e Shoqërisë Shpresa-AL sh.p.k., lidhur me kompesimet që të verbërit duhet të marrin sipas ndryshimeve të ligjit nr. 8098, datë 28.03.1996 “Për statusin e të verbërit”.
3. Nëse ndryshimet ligjore të ligjit nr. 8098, datë 28.03.1996 “Për statusin e të verbërit”, parashikojnë kompensimin e transportit qytetas për personat e verbër, të merren masa ndaj organeve kompetente dhe konstatimin e këtij parashikimi ligjor si diskriminues për kategorinë e personave të verbër.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri

Në nenin 1 të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, parashikohet objekti i këtij ligji, duke u sanksionuar se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet

² Nëpërmjet autorizimit datë 18.02.2021.

gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

Neni 7 i LMD-së³, të ndryshuar, në pikën 1 të tij, parashikon se: “Çdo veprim ose mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë apo privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta apo të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë apo grupe personash, përbën diskriminim”.

Subjekti ankues legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të nenit 33, pikat 2 dhe 3, të LMD-së. Subjekti legjitimohet *ratione tempore*, në kuptim të nenit 33, pika 4, gërma dh, të LMD-së.

Subjektet ankues gjithashtu, legjitimohen *ratione materia*, pasi pretendimet e tyre *prima facie*, janë të tilla që bëjnë pjesë në kompetencat që ligji, i njuh Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, për shqyrtimin e ankesës në kuptim të nenit 32, pika 1, gërma b, të LMD-së, si dhe ankuesit kanë provuar interesin e tyre të drejtëpërdrejtë përse i takon pretendimit për cënim të parimit të barazisë e trajtimit në mënyrë të barabartë krahasuar me kategori të tjera të personave me aftësi të kufizuara.

Përse më lart, referuar neneve sipërcituar të LMD-së, ankesa përmban elementët e kërkuar nga ky ligj.

Në zbatim të parashikimeve ligjore, të përcaktuara në nenet 32 dhe 33, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

1. Nëpërmjet shkresës me nr. 328/1 prot., datë 02.03.2021 nga ana e KMD i është kërkuar informacion dhe dokumentacion provues⁴ Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë; Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Shoqërisë Shpresa AL, lidhur me pretendimet e subjekteve ankues.

Në përgjigje përse më sipër, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, me anë të shkresës⁵ nr. 1207/1 prot., datë 06.04.2021, informoi Komisionerin ndër të tjera se: “...Ministria e

³Akronim për Ligjin për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

⁴ Është kërkuar konkretisht:

- Argumentimin, lidhur me pretendimet e subjektit ankues.
- Informacion nga ana e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, sipas fushave përkatëse të kompetencës, për plotësimin e legjislacionit, nëse janë marrë masa për nxjerrjen e akteve nënligjore në zbatim të nenit 11, të ligjit nr. 8098, datë 28.03.1996 “Për statusin e të verbërit” (i ndryshuar).
- Informacion nga ana e Shoqërisë së Transportit “Shpresa-AL” sh.p.k., lidhur me situatën e pretenduar nga ana e palës ankuese.

⁵ Protokolluar pranë KMD-së me Nr. 328/1 prot., datë 08.04.2021

Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, ka qënë në bisedime të vazhdueshme me aktorë të ndryshëm, përfaqësues të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Bashkisë Tiranë, për të zgjidhur problematikat që lidhen me transportin e kategorive të veçanta.

Duke u ndodhur në kushtet e fatkeqësive natyrore që goditën vendin tonë në dy vitet e fundit, burimet financiare të buxhetit të shtetit u adresuan në ndihmë të kategorive të prekura. Gjatë këtij viti dhe gjatë procesit të planifikimit të buxhetit afatmesëm 2022-2024, do të merret në shqyrtim dhe do të vlerësohet efekti financiar që rrjedh nga skema e kompensimeve për udhëtim për transportin qytetes dhe ndërqytetas dhe do të kërkohet miratimi i fondeve shtesë nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë...”.

Në përgjigje përsa më sipër, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, me anë të shkresës⁶ nr. 2275/1 prot., datë 15.04.2021, informoi Komisionerin ndër të tjera se: “... Referuar ligjit nr. 8308, datë 18.3.1998 ‘Për Transportet Rrugore’, i ndryshuar dhe konkretisht nenit 15 të tij konkretisht thuhet: ‘Transporti i udhëtarëve në linja rreth-qytetese është shërbim i rregullt transporti, i cili plotëson nevojat e lëvizjes së popullsisë ndërmjet njësive administrative përbërëse dhe qendrës së bashkisë së cilës i përkasin. Ky lloj transporti kryhet nga persona juridik ose fizik, të pajisur me licencë. Licenca për transportin rreth qytetës jepet nga kryetari i bashkisë ku ka selinë subjekti transportues.

Rasti i paraqitur me lart është nën juridiksionin e pushtetit vendor dhe për rrjedhojë është pikërisht ky i fundit i cili është vendimmarrës në këtë drejtim. Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, referuar VKM nr. 504, date 13.9.2017 ‘Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, ka tagrin për të propozuar projekt-akte, objekti i të cilave përfshihet në fushën e përgjegjësisë së saj, ndërkohë që hartimi i politikave dhe ‘ndërmarrja e nismave për propozimin e akteve ligjore/nënligjore për kategori të veçanta të qytetarëve është tagër ligjor i ministrive të linjës që mbulojnë fushën përkatëse.”

Në përgjigje përsa më sipër, Shoqata e Transportit Urban dhe Interurban Kamëz Veri (ka kthyer përgjigje në emër të Shoqërisë së Transportit Shpresa AL), me anë të shkresës⁷ nr. 60 prot., datë 23.04.2021, informoi Komisionerin ndër të tjera se: “...Mbi situatën e hasur të “Shoqatës shpresë për të Verbërit” për njohjen e lëvizshmërisë në transport urban falas dhe atë interurban me gjysëm çmimi (Janë disa shoqata p.sh. dhe Shoqata Kombëtare për të Verbërit e cila në 2019 kishte një numër të madh librezash për shpërndarje dhe pa verifikim, ku u ballafaquam te komisarati i Policisë Kamëz dhe nuk u shpërndan sepse nuk dihet nga vinin, vetëm në qarkun e Tiranës janë mbi 18.000 individ me statutin e të verbërit)...

Punonjësit e subjektit në fjalë janë të trajnuar për veprimet dhe sjelljen që bëjnë në autobuzët e punës, e kur ka pasur probleme kanë mbajtur dhe përgjegjësi, po në rastin konkret sqarojmë situatën se në linjat urbane në Bashkinë Kamëz njihen kategoritë që udhëtojnë falas sipas ligjeve në fuqi, ‘pavarësisht se asnjëri nga subjektet që ne përfaqësojmë s’kanë marrë asnjë kompensim

⁶ Protokolluar pranë KMD-së me Nr. 328/2 prot., datë 22.04.2021

⁷ Protokolluar pranë KMD-së me Nr. 328/3 prot., datë 26.04.2021

nga institucionet përgjegjëse, duke i imponuar subjektet që të mbajnë në ngarkim kostot. Jemi tatim pagues të rregullt dhe zinxhiri ekonomik që përfaqësojmë si transport publik në Republikën e Shqipërisë është mbi 30.000 të punësuar duke qënë një ndër kontribuesit më të mëdhenj në buxhetin e shtetit, por pavarësisht kësaj nuk jemi rimbursuar asnjëherë për kategoritë që udhëtojnë falas'. Kujtojmë se subjekti pjesë e shoqatës ishte ndër kontribuesit kryesor në kohën e tërmetit duke vënë në dispozicion mjete transporti dhe duke kontribuar në mënyrë të vazhdueshme me mallra ushqimore dhe vlera monetare.

Edhe në kohën e mbylljes totale të transportit nga Covid-19 subjekti 'Shpresa AL' shpk kontriboi për një periudhë 4- mujore duke vënë në dispozicion të stafit mjekësor dy autobusë me nga 3 rrugë vajtje e 3 rrugë ardhje pa pagesë. Nga kjo dua të sqarojë se nga ana jonë nuk është bërë asnjë lloj diskriminimi për asnjë lloj kategorie të udhëtarëve, për ne janë të gjithë njëllor dhe zbatohet ana ligjore siç është e parashikuar, për ne prioritet janë qytetarët që mundohemi t'ju shërbejmë me korrektësi dhe përkushtim maksimal."

2. Mbështetur në nenin 33/8, të Ligjit 10221/2010 "Për Mbrojtjen nga Diskriminimi", të ndryshuar, për shqyrtimin e mëtejshëm të ankesës nr. 19, datë 19.02.2021, Komisioneri me shkresën nr. 328/4, datë 30.04.2021 njoftoi, Këshillin e Ministrave, Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Shoqatën e Transportit Urban dhe Interurban Kamëz Veri dhe ankuesit për zhvillimin e seancës dëgjimore me datë 10.05.2021, për të parashtruar dhe argumentuar në mënyrë të drejtpërdrejtë pretendimet e tyre dhe për të sqaruar të gjitha faktet dhe provat e palëve në proces.

Seanca dëgjimore u zhvillua në mungesë të përfaqësuesve të Këshillit të Ministrave dhe Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, dhe në prezencë të:

- Shoqatës "Shpresë për të verbërit" (në vijim Shoqata), përfaqësuar nga kryetari i saj, S. F. dhe K. M.
- Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë (në vijim MIE), përfaqësuar nga Përgjegjësjja e Sektorit të Monitorimit të Transportit, shtetësja E. T.
- Shoqatës së Transportit Urban dhe Interurban Kamëz Veri (paraqitur në emër të Shoqërisë së Transportit Shpresa AL), përfaqësuar nga shtetasi D. M.

Gjatë seancës dëgjimore, përfaqësuesit e Shoqatës "Shpresë për të verbërit", i qëndruan të njëjtave parashtrime që kishin bërë të njohura gjatë procedurës së shqyrtimit të ankesës. Ndërkaq, theksuan faktin që mungesa e miratimit të akteve nënligjore sa i përket rimbursimit të transportit për personat e verbër, është bërë shkak që ata të përballen me përfaqësuesit e shoqërive të transportit rrugor. Gjithashtu, një fakt tjetër i cili u theksua gjatë seancës nga ana e tyre, ishte njohja e librezës së invaliditetit të lëshuar nga Shoqata e Invalidëve të Punës së Shqipërisë, ndërsa librezja e lëshuar nga shoqata e tyre nuk njihej.

Në vijim nga përfaqësuesja e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë u theksua ndër të tjera se, institucioni që ajo përfaqëson nuk ka kompetenca për të vendosur masën e rimbursimit të

personave të verbër apo të subvencionimit të biletave për shoqëritë e transportit. Në këtë kuadër, sipas saj, janë një sërë aktorësh të cilët duhet të bashkëvepronin për të hartuar aktet nënligjore dhe masën për subvencionim të shoqërive të transportit apo rimbursimin e transportit për personat e verbër. Ndërkaq, sipas përfaqësueses së MIE-së, ligji Nr. 8308, datë 18.3.1998 “*Për Transportet Rrugore*”, i ndryshuar, në nenin 85 të tij parashikon se fondet për kompensimin e tarifës së transportit të personave me aftësi të kufizuara, përballohen nga institucionet që i licensojnë ato. Duke qenë se shoqëritë e transportit qytetas licensohen nga ana e njësive të vetëqeverisjes vendore, sipas saj, në rastin konkret është Bashkia Kamëz ajo që duhet të rimbursojë shoqëritë e transportit që ushtrojnë aktivitetin në këtë njësi, për personat me aftësi të kufizuara. Gjithashtu, përfaqësuesja e MIE, sqaroi se edhe Udhëzimi 5627, datë 18.11.2016 “*Për përcaktimin e kriterëve, rregullave dhe dokumentacionit për lëshimin e licencave dhe certifikatave për ushtrimin e veprimtarisë në transportin rrugor të udhëtarëve brenda vendit*”, parashikon se subjektet e transportit publik, janë të detyruara të zbatojnë legjislacionin në fuqi për personat me aftësi të kufizuara dhe t’i krijojnë kësaj kategorie lehtësira në transport. Në këtë kuptim, moszbatimi i legjislacionit, përbën shkelje të rëndë e cila shkon deri në pezullimin apo heqjen e licensës ose certifikatës së mjetit. Po ky udhëzim, sipas saj, në formatet e certifikatave të mjeteve, ka përcaktuar detyrimet që kanë subjektet e transportit për të zbatuar legjislacionin për personat me aftësi të kufizuara. Në momentin që subjekteve u është miratuar licensa dhe certifikata, ata kanë pranuar/miratuar edhe zbatimin e këtij legjislacioni.

Nga përfaqësuesi i Shoqatës së Transportit Urban dhe Interurban Kamëz Veri, u theksua se në vijimësi ata kanë kërkuar nga ministritë përgjegjëse apo njësitë e vetëqeverisjes vendore, të kompensohen për kategoritë që udhëtojnë falas, po nuk kanë marrë asnjë reagim prej tyre. Sipas tij, Shoqata e të Verbërve të Shqipërisë dhe Avokati i Popullit, kanë dërguar në Gjykatën Kushtetuese ankimin sa i përket ndryshimeve të pësuara në ligjin nr. 8098, datë 28.03.1996 “*Për statusin e të verbërit*”, pasi sipas tyre, ndryshimet e bëra në këtë akt kanë qenë antikushtetuese, por nga ana e kësaj gjykate është rrëzuar kërkesa. Në vijim, u sqarua se Shoqata e Transportit Urban dhe Interurban Kamëz Veri, mbështetin dhe kanë mbështetur personat me aftësi të kufizuara, si dhe i kanë krijuar kushtet për të udhëtuar, por nuk mund të zhvillojnë aktivitetin e tyre në shkelje të legjislacionit apo të dëmtohen financiarisht për shkak të mangësive ligjore apo nënligjore. Gjithashtu, ai sqaroi faktin që gjatë aktivitetit të ushtruar, shoqëritë e ndryshme të transportit kanë konstatuar një numër të madh të librezave të personave me aftësi të kufizuara të cilat kanë qenë të falsifikuara. Për këtë arsye, nga ana e tij u kërkuar të gjendjet një zgjidhje në mënyrë që shoqëritë e transportit dhe personat me aftësi të kufizuara të mos kenë në vijim asnjë lloj konflikti apo diskutimi sa i përket tarifave.

Në përfundim, nga ana e përfaqësuesve të Komisionerit, u kërkuar nga MIE të vërë në dispozicion të shqyrtimit të çështjes, informacion sa i përket hapave të ndërmarrë për rastit konkret.

3. Në vijim, nëpërmjet shkresës me nr. 881 prot., datë 09.06.2021, nga ana e KMD i është kërkuar informacion dhe dokumentacion⁸ provues Bashkisë Kamëz, lidhur me pretendimet e subjekteve ankues.

Në përgjigje të shkresës së sipërcituar, Bashkia Kamëz me shkresën⁹ nr. 6038/1 prot., datë 22.06.2021, përcolli pranë KMD-së vetëm kopje të Kontratave të lidhura ndërmjet saj dhe Shoqërisë së Transportit Shpresa AL dhe asnjë informacion shtesë.

III. Vlerësimi i fakteve nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.

A. Lidhur me me trajtimin e padrejtë, të pabarabartë e të pafavorshëm.

Në ankesën e Shoqatës “Shpresë për të verbërit”, pretendohet për diskriminim të kategorisë së personave me aftësi të kufizuara, të verbër, për shkak të aftësisë së kufizuar, nga ana shoqërisë së transportit Shpresa AL. Gjatë shqyrtimit të ankesës, Komisioneri evidentoi se Bashkia Kamëz është subjekti i cili licenson shoqëritë e transportit që ushtrojnë aktivitetin qytetas në territorin që ajo mbulon. Në këtë kuadër, Komisioneri bëri pjesë të procedurave hetimore dhe këtë njësi të vetëqeverisjes vendore, si subjekt ndaj të cilit shqyrtohet ankesa e Shoqatës “Shpresë për të verbërit” dhe K. M.

Diskriminimi i pretenduar nga shoqata e sipërpërmendur mbështetet në faktin se personave të verbër në linjën e transportit urban të Bashkisë Kamëz, nuk u ofrohet shërbimi i transportit urban qytetas falas, ndërkohë që një gjë e tillë është e parashikuar në legjislacionin përkatës.

Mbështetur në legjislacionin në fuqi¹⁰ që rregullon fushën e transportit, transporti rrugor i udhëtarëve brenda vendit në formën e shërbimit të linjave të rregullta, ndahet në: (1) transport qytetas, (2) transport rrethqytetas¹¹ dhe (3) transport ndërqytetas¹². Transporti qytetas që përbën objektin e kësaj ankese, bën pjesë në kompetencat e pushtetit vendor. Ndërkohë që, transporti ndërqytetas rregullohet nga ministri përgjegjës për veprimtarinë e transportit. Kjo ndarje e kompetencave sipas llojeve të transportit, ngarkon me përgjegjësi pushtetin qendror dhe atë vendor.

-
- ⁸ Informacion nëse janë realizuar monitorime nga ana e strukturave të Bashkisë Kamëz ndaj Shoqërisë së Transportit Shpresa AL, lidhur me respektimin e të drejtave të personave me aftësi të kufizuara. Nëse po, të vihet në dispozicion të Komisionerit informacioni i administruar nga monitorimet e kryera.
 - Informacion nëse gjatë monitorimeve të ushtruara ndaj Shoqërisë së Transportit Shpresa AL, janë evidentuar problematika lidhur me mosofrimin e transportit falas për kategori të ndryshme të personave me aftësi të kufizuara, në veçanti për personat e verbër. Nëse po, të vihet në dispozicion të Komisionerit informacioni i administruar nga monitorimet e kryera.
 - Kopje të Kontratës Tip të nënshkruar mes Bashkisë Kamëz dhe Shoqërisë së Transportit Shpresa AL.

⁹ Protokolluar pranë KMD-së me nr. 881/1 prot., datë 24.06.2021

¹⁰ Ligji nr. 8308, datë 18.03.1998 “Për transportet rrugore” (i ndryshuar) dhe aktet nënligjore të miratuara në zbatim të tij.

¹¹ Transporti rrethqytetas nuk bën pjesë në objektin e shqyrtimit të kësaj ankese.

¹² Transporti ndërqytetas nuk bën pjesë në objektin e shqyrtimit të kësaj ankese.

- 1) Me qëllim identifikimin e bazës ligjore që përmban parashikime pozitive, lidhur me përfitimin e transportit falas për kategorinë e personave të verbër, Komisioneri, mori në analizim Ligjin nr. 8098, datë 28.03.1996 “Për Statusin e të Verbërit” (Ndryshuar me ligjin nr. 26/2012, datë 15.03.2012). Referuar dispozitave të ligjit të sipërpërmendur, rezultoi se, fillimisht neni 11, i këtij ligji parashikonte shprehimisht: *“Të verbërit kanë të drejtë që ata vetë dhe shoqëruesit e tyre të udhëtojnë falas në transportin urban, dhe me gjysmë çmimi në transportin interurban, duke përfshirë atë shtetëror dhe privat.”*

Në vijim, neni 11, i ligjit të sipërpërmendur është ndryshuar, nëpërmjet ligjit nr. 26/2012, datë 15.03.2012 “Për disa ndryshime në ligjin nr. 8098, datë 28.03.1996 “Për Statusin e të Verbërit”. Aktualisht, ky nen parashikon: *“Të verbërit dhe shoqëruesit e tyre përfitojnë kompensim për shërbimin e transportit. Masa, kriteret dhe procedurat e këtij përfitimi përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.”*

Sikurse vihet re nga sa më sipër, pas ndryshimeve, që i janë bërë në vitin 2012, Ligjit nr. 8098, datë 28.03.1996 “Për Statusin e të Verbërit” (i ndryshuar), personat e verbër nuk përfitojnë më transport qytetas/urban¹³ falas dhe transport interurban¹⁴/ndërqytetas me 50% të vlerës së biletës. Me ndryshimet ligjore, kjo kategori do të përfitojë kompesim për shërbimin e transportit. Masa, kriteret dhe procedurat e këtij përfitimi përcaktohen me Vendim të Këshillit të Ministrave, i cili nuk është miratuar ende.

Edhe legjislacioni i miratuar në fushën e transportit përmban parashikime të përgjithshme mbi lehtësitë, që duhet të përfitojnë në shërbimin e transportit urban qytetas, për shtresat dhe kategoritë vunerabël, por gjithmonë duke kryer referencën përkatëse, në ligjet e posaçme për secilën kategori. Për sa më sipër, neni 85, i ligjit nr. 8308, datë 18.03.1998 “Për transportet rrugore” (i ndryshuar)¹⁵ parashikon:

“Është e detyrueshme të kryhet perkujdesja dhe transporti me përparësi, kundrejt të gjitha lehtësive që jep ligji, për të gjitha subjektet që i përfitojnë këto lehtësi në transportin qytetës dhe jashtë qytetit, duke përcaktuar me shënim të veçantë edhe vendet e ndenjjes për ta.

¹³ Terminologji e përdorur në këto ligje;

¹⁴ Terminologji e përdorur në këto ligje;

¹⁵ Ligji nr. 8308, datë 18.03.1998 “Për transportet rrugore” (i ndryshuar me ligjin nr. 10/2016, “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8308, datë 18.03.1998 “Për transportet rrugore”, ligjin nr. 37/2014 “Për disa shtesa në ligjin nr. 8308, datë 18.03.1998 “Për transportet rrugore”, ligjin nr. 21/2013, “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8308, datë 18.03.1998 “Për transportet rrugore”, ligjin nr. 10 302, datë 15.07.2010 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8308, datë 18.03.1998 “Për transportet rrugore”, ligjin nr. 9760, datë 21.06.2007 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8308, datë 18.03.1998 “Për transportet rrugore”, ligjin nr. 9373, datë 14.04.2005, “Për disa ndryshime në ligjin nr. 8308, datë 18.03.1998 “Për transportet rrugore”, ligjin nr. 9096, datë 03.07.2003, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8308, datë 18.03.1998 “Për transportet rrugore”, ndryshuar me ligjin nr. 8908, datë 06.06.2002”, ligjin nr. 8908, datë 06.06.2002 “Për disa ndryshime në ligjin nr. 8308, datë 18.03.1998 “Për transportet rrugore”).

Udhëtarët që përfitojnë lehtësi me ligje të veçanta, duhet të paraqesin në çdo rast udhëtimi dokumentin që përcakton ligji për ta.

Fondet për kompensimin e tarifës së transportit të kategorive të personave, që përfitojnë nga legjislacioni në fuqi për transportin qytetas, përballohet nga institucionet përgjegjëse, sipas ligjit. Masa, kriteret dhe procedurat për kompensimin e kësaj tarife përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave."

Për sa më sipër, edhe neni 85, i ligjit 8308, datë 18.03.1998 "Për transportet rrugore", i ndryshuar, ka vendosur detyrimin dhe ka autorizuar nxjerrjen e një akti nënligjor nga ana e Këshillit të Ministrave, i cili duhet të përcaktojë, masat, kriteret dhe procedurat për kompesimin e tarifës së transportit qytetas për udhëtarët që përfitojnë lehtësi me ligje të veçanta. Ky akt nënligjor nuk rezulton të jetë miratuar.

Në referencë të akteve nënligjore të miratuara në fushën e transportit, Komisioneri është fokusuar edhe në parashikimet e Vendimit nr. 85, datë 08.02.2017, të Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e rregullave për prodhimin shpërndarjen dhe pajisjen e udhëtarëve me bileta transporti rrugor", ku është përcaktuar se të drejtën për të përcaktuar çmimet e biletave për kategoritë që përfitojnë lehtësira në transportin qytetas/rrethqytetas me ligje të veçanta, e kanë, këshillat e njësive të vetëqeverisjes vendore, në përputhje me legjislacionin në fuqi për këtë qëllim. Pika 7, e Vendimit nr. 85, datë 08.02.2017, i Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e rregullave për prodhimin shpërndarjen dhe pajisjen e udhëtarëve me bileta transporti rrugor" parashikon: "Për udhëtarët, që përfitojnë lehtësi me ligje të veçanta, çmimi i biletave për **transportin qytetas dhe rrethqytetas caktohet në përputhje me legjislacionin në fuqi për këtë qëllim, me vendim të këshillit të njësive të vetëqeverisjes vendore**".

Në referencë të Udhëzimit nr. 5627, datë 18.11.2016, të Ministrit të Transportit dhe Infrastrukturës "Për përcaktimin e kriterëve, rregullave dhe dokumentacionit për lëshimin e liçencave dhe çertifikatave për ushtrimin e veprimtarisë në transportin rrugor të udhëtarëve brenda vendit", Bashkitë janë organet kompetente për lëshimin e liçencave dhe çertifikatave për operatorët e shërbimit urban qytetas.

Në vijim, vlen të përmendet edhe Udhëzimi nr. 3743, datë 10.07.2017, i Ministrit të Transportit dhe Infrastrukturës, "Mbi modelet dhe standartet e biletave të transportit rrugor të udhëtarëve". Ky udhëzim bën një identifikim të grupeve, që përfitojnë lehtësira financiare në marrjen e shërbimeve publike në përputhje me kuadrin ligjor, por jo llojin e lehtësirave që përfitojnë. Personat që u përkasin kategorive apo grupeve në fjalë, pajisen me *Kartat standarde të personalizuar*. Në pikën 5.3.2.1, 5.3.2.2 dhe 5.3.2.4 përcaktohen si të tillë: invalidët e punës, të verbrit dhe invalidët paraplegjikë dhe tetraplegjikë. Në pikën 5.3.2.6, të Udhëzimit nr. 3743/2017, parashikohet si përfitues edhe çdo subjekt ose kategori që mund të përfitojë në vijim, mbështetur në legjislacionin në fuqi.

Për sa më sipër, rezulton se personat me aftësi të kufizuara që gëzojnë statusin e të verbrit gëzojnë lehtësira në shërbimin e transportit, duke përfshirë këtu të treja format e transportit me linja të

rregullta, pra transport qytetas, rrethqytetas dhe ndërqytetas. Transporti qytetas dhe rrethqytetas, janë kompetencë e pushtetit vendor. Referuar akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi, pushteti vendor ka kompetencën për të përcaktuar linjat, për të licencuar subjektet dhe për të përcaktuar çmimin e biletave për kategoritë që përfitojnë lehtësira në transport. Kjo kategori është përfituese e kompesimit, i cili nuk është përcaktuar akoma në çfarë mase, si dhe nuk janë përcaktuar kriteret për përfitimin e tij, pasi nuk është miratuar ende akti nënligjor, që duhet të bëjë përcaktime të tilla.

Nga dokumentacioni dhe informacioni i administruar rezulton se problematika e mospërfitimit të lehtësirave në transportin urban qytetas është një problematikë e parashtruar sipas informacionit të dhënë nga Shoqata e Transportit Urban dhe Interurban Kamëz Veri dhe Shoqata “Shpresë për të verbërit”. Sipas tyre, ata kanë depozituar disa kërkesa dhe ankesa, pranë MIE-së dhe MSHMS-së, por edhe në institucione e dikastere të tjera të pushtetit vendor, lidhur me sigurimin e lehtësirave në transportin publik qytetas.

Nisur nga problematika e paraqitur nga Shoqata në mbrojtje të interesave të personave me aftësi të kufizuara, Ministri i Mirëqënies Sociale dhe Rinisë i është drejtuar, nëpërmjet shkresës¹⁶ nr. 3129, datë 28.05.2014, të gjithë Kryetarëve të Bashkive dhe për djepin Prefektëve të Qarqeve, ku nisur nga problematika e paraqitur nga shoqatat e invalidëve të punës, lidhur me sigurimin e lehtësive në transportin urban për këtë kategori, i udhëzon titullarët e këtyre institucioneve, si vijon: *“Aktualisht, Ministria e Mirëqënies Sociale dhe Rinisë është në procesin e vlerësimit dhe të hartimit të projektvendimeve për përcaktimin e mënyrës së kompensimit të shërbimit të transportit për kategoritë që përfitojnë lehtësira në transport sipas legjislacionit në fuqi. E drejta e invalidëve të punës për udhëtimin falas në mjetet e komunikacionit qytetas privat është e përcaktuar edhe në dokumentacionin licencues dhe certifikues të shoqërive të transportit.....Duke qenë se autoritetet përgjegjëse për lëshimin e këtyre licencave janë njësitë e qeverisjes vendore, ato duhet të marrin të gjitha masat e nevojshme për plotësimin e detyrimeve të parashikuara në licencë për subjektet që kryejnë transport rrugor. Në rast të kundërt mund të kërkojnë heqjen e licencës për subjektet që nuk i përmbushin këto detyrime. Nga sa më lart, Ministria e Mirëqënies Sociale dhe Rinisë kërkon zbatimin e dispozitave ligjore në fuqi, si dhe detyrimeve që kanë shoqëritë e transportit bazuar në dokumentacionin e tyre licencues dhe certifikues, në lidhje me të drejtën e invalidëve të punës për udhëtim falas me mjetet e komunikacionit qytetas privat. Gjithashtu kërkojmë vëmendjen e njësive të qeverisjes vendore në mbikqyrjen e vazhdueshme të respektimit të detyrimeve kontraktuale mbi këtë të drejtë të invalidëve të punës nga shoqëritë e transportit”.*

Për sa më sipër, rezulton se pavarësisht mungesës së aktit nënligjor, i cili do të përcaktojë masën, kriteret dhe procedurat e kompensimit të shërbimit të transportit për kategorinë e të verbërve dhe vonesës së zgjatur për nxjerrjen dhe miratimin e këtij akti nënligjor, ministri përgjegjës i ka dhënë një zgjidhje të përkohëshme çështjes në fjalë, duke mos cënuar të drejtën e invalidëve të punës, sikurse për analogji edhe kategorisë së personave të verbër, për të gëzuar lehtësi në transportin urban qytetas.

¹⁶ Administruar në çështjen e trajtuar nga KMD me Nr. 192 rregj., datë 18.12.2018, të Shoqatës së Invalidëve Paraplegjikë dhe Tetraplegjikë, Dega Shkodër.

Për të realizuar një shërbim të tillë, në mungesë të aktit nënligjor ende të pamiruar, ai udhëzon që njësitë e qeverisjes vendore në zbatim të kompetencave që atyre u atribuon legjislacioni në fuqi, të mbikqyrin në mënyrë të vazhdueshme respektimin e detyrimeve kontraktuale nga ana e operatorëve të shërbimit urban, si dhe u kujton këtyre njësive se e drejta e transportit falas të kategorive të personave me aftësi të kufizuar është e përcaktuar në dokumentacionin licencues dhe certifikues të shoqërive të transportit, ku këto të fundit lëshohen nga organet e qeverisjes vendore.

- 2) Në vijim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri analizoi edhe përmbajtjen e Kontratave të Shërbimit, të lidhura ndërmjet Bashkisë Kamëz dhe Shoqërisë Shpresa AL, përkatësisht Kontratës nr. 674, datë 15.02.2017, “*Për transportin e udhëtarëve në linjën rrethqytetëse “Kamëz-Tiranë-Kamëz” të Bashkisë Kamëz.*”

Neni 9, i kontratës së sipërcituar parashikon shprehimisht: “Kontraktori detyrohet që të garantojë udhëtimin e të gjithë kategorive të udhëtarëve që sipas legjislacionit në fuqi që përfitojnë lehtësira në udhëtim, si: Udhëtimi me bileta pajtimi (abone), udhëtimin pa pagesë kundrejt paraqitjes së dokumentit që parashikon ligji për to, etj.”

Neni 10, përcakton se: “Kontraktori merr përsipër të kryejë shërbimin e transportit në linjën përkatëse, të përmbushë detyrimin sipas nenit 8 dhe 9 të cituar më lart, kundrejt subvencionit të kontratës, vetëm pas miratimit në Këshillin Bashkiak të financimit të subvencioneve (miratimi i planifikimit në Buxhetin e Bashkisë ose me VKM).”

Për sa më sipër, rezulton se Shoqëria Shpresa AL, me të cilën Bashkia Kamëz ka lidhur kontratë shërbimi, ka detyrim kontraktual ofrimin e shërbimit urban qytetas falas për kategorinë e personave të verbër.

Në këtë kontekst, Komisioneri gjykon se Bashkia Kamëz ka patur të gjitha mundësitë për të mos e lënë të thellohej problematika e mosofrimit të shërbimit të transportit urban falas, jo vetëm për kategorinë e të verbërve, por edhe për kategoritë e tjera të parashikuara në nenin 9, të kontratës së shërbimit, të lidhur me operatorin e shërbimit urban Shpresa AL.

Përveç sa më sipër, Bashkia Kamëz, në cilësinë e autoritetit që lëshon licencat dhe certifikatat për operatorët e shërbimit urban, në referencë të pikës 4, të Lidhjes 4, së Udhëzimit nr. 5627, datë 18.11.2016, të Ministrisë të Transportit dhe Infrastrukturës “*Për përcaktimin e kritereve, rregullave dhe dokumentacionit për lëshimin e licencave dhe certifikatave për ushtrimin e veprimtarisë në transportin rrugor të udhëtarëve brenda vendit*”, ku parashikohet: “*Mbajtësi i licencës dhe i kësaj çertifikate mban përgjegjësi për zbatimin e ligjeve nr.7889/94, të ndryshuar, nr. 7663/93, nr. 8626/00, të ndryshuar në të cilat përcaktohet: a) Për transportin qytetës: - “invalidët e punës, invalidët e luftës, invalidët paraplegjikë dhe tetraplegjikë, të cilët nga organizatat përkatëse janë të pajisur me dëshmi, kanë të drejtë të udhëtojnë falas”, si dhe për zbatimin e ligjeve nr. 8098/96,*

nr. 8153/96, të ndryshuar; -“të verbërit e shoqëruesit e tyre dhe jetimët që nuk janë në marrëdhënie pune, udhëtojnë falas”, duhej të kishte vepruar menjëherë kundrejt moszbatimit të këtij udhëzimi.

Problematika e parashtruar nga pala ankuese, sa i përket transportit urban qytetas, është një fakt i bërë publik që nga viti 2012, kur janë miratuar ndryshimet në ligjin nr. 8098, datë 28.03.1996 “Për Statusin e të Verbërit” apo edhe ligjeve të tjera të cilat kanë prekur kategori si: invalidët para dhe tetraplegjik etj. Në këtë kuadër, Shoqata e të Verbërve të Shqipërisë, ka kërkuar publikisht¹⁷ në vijimësi, për gjetjen e një zgjidhje për kategorinë e të verbërve, sa i përket transportit.

Nga informacioni i administruar nga palët, Bashkia Kamëz ka qenë në dijeni të situatës së krijuar ndërmjet operatorit të transportit publik Shpresa AL dhe kategorive të personave që përfitojnë udhëtimin pa pagesë në territorin e saj. Pavarësisht kësaj, nuk rezulton të ketë pasur përpjekje nga ana e Bashkisë për rregullimin përfundimtar të situatës si nga ana saj, duke shfrytëzuar legjislacionin në fuqi ashtu edhe në lidhje me pushtetin qëndror. Gjithashtu, edhe pse referuar dokumentacionit të depozituar, Bashkia Kamëz ka ushtruar kontroll të itenerareve të linjave të transportit të Shoqërisë Shpresa AL, në asnjë rast nuk rezulton të ketë kryer ndonjë kontroll sa i përket respektimit të kontratës së shërbimit të lidhur me këtë shoqëri.

Në përfundim, Komisioneri gjykon se me anë të veprimeve apo mosveprimeve të saj, Bashkia Kamëz ka ekspozuar kategorinë e personave të verbër, ndaj një trajtimi të padrejtë dhe disfavorizues, sa i përket transportit urban qytetas pa pagesë.

- 3) Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri analizoi pretendimin e subjekteve ankues sa i përket veprimeve nga ana e punonjësve të transportit publik të Shoqërisë Shpresa AL.

Nga informacioni i administruar, subjektet ankues kanë pretenduar se, në momentin që kanë paraqitur pranë punonjësit (faktorinos) të Shoqërisë Shpresa AL librezën e verbërisë, nga ana e këtij të fundit, i është sqaruar se ajo nuk njihet nga shoqëria e transportit dhe për këtë arsye i duhej të paguanin biletën e plotë të transportit. Ndërkaq, nga ana e punonjësit të shoqërisë së transportit, veç të tjerash i është marrë edhe librezë e verbërisë, pa miratimin e subjekteve ankues, dhe i është dorëzuar dispeçerit të shoqërisë Shpresa AL.

Vendimi i Këshillit të Miniaturave Nr. 277, datë 18.06.1997 “Për Përfitimet nga Statusi i të Verbërit”, i ndryshuar, në pikën 3 të tij parashikon se: “Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit Social Shtetëror i lëshon personit të verbër librezën e verbërisë, si dokument prove për përfitimin nga ligji nr. 8098, datë 28.03.1996 “Për statusin e të verbërit”, pas marrjes së vendimit nga Komisioni Mjekësor për Përcaktimin e Verbërisë. Modeli i librezës së verbërisë përcaktohet nga Ministri i Punës, Çështjeve Sociale dhe Shansëve të Barabarta.”

¹⁷ <https://www.balkanweb.com/shteti-u-ka-borxh-nga-2-mln-leke-te-verbrit-nenshkruajne-peticion/>
<http://www.respublica.al/arki-v-lajme-të-përditësuarat/të-verbërit-në-protestë-kundër-ndryshimit-të-statusit>

Ndërsa në pikën 15, parashikohet se: *“Për çdo shpërdorim në favoret dhe lehtësitë e bëra nga ligji, personit përgjegjës i merret librezat për një periudhë deri në 3 vjet, dënohet me gjobë për kundërvajtje administrative sipas dispozitave në fuqi dhe, kur është rasti, organi që e konstaton shkeljen, bën denoncim për ndjekje penale.”*

Në këtë kuptim, veprimi i punonjësve të Shoqërisë Shpresa AL, të cilët nuk njohin librezën e verbërisë së lëshuar nga Shërbimi Social Shtetëror dhe ja marrin personave të verbër, është një veprim i pa arsytuar, i pa mbështetur në asnjë akt ligjor apo nënligjor dhe i padrejtë. Pavarësisht faktit, nëse punonjësve të transportit të Shoqërisë Shpresa AL apo çdo shoqërie tjetër transporti, të cilëve mund t’i lind dyshimi se librezat e verbërisë apo të invaliditetit janë të falsifikuara apo po keqpërdoren, nuk i lind e drejta e marrjes së tyre nga personi që e disponon atë. Ndërkaq, edhe nëse ekziston dyshimi për falsifikimin apo keqpërdorimin e tyre, punonjësit e shoqërive të transportit duhet t’i drejtohen institucioneve të cilat i lëshojnë dhe organeve përgjegjëse, për të sinjalizuar shkeljet apo abuzimet e pretenduara dhe jo të veprojnë si në rastin konkret, duke u’r marrë personave që i disponojnë ato.

B. Shkaku i mbrojtur.

Mbështetur në nenin 2¹⁸, të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, në ushtrimin e detyrës së tij siguron mbrojtjen efektive nga diskriminimi dhe çdo formë sjelljeje që nxit diskriminimin për një nga shkaqet që parashikon ky ligj. Ligji për mbrojtjen nga diskriminimi ndalon situatat kur persona ose grupe personash në një situatë të njëjtë trajtohen në mënyra të ndryshme, dhe situatat kur personat ose grupet e personave në situata të ndryshme trajtohen njësoj.

Në nenin 1 të tij, përcaktohet se: *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”*.

Në lidhje me pretendimin e subjekteve ankues për diskriminim për shkak të *“aftësisë së kufizuar”*, Komisioneri gjykon se ky shkak konsiderohet si një shkak i mbrojtur, pasi jo vetëm parashikohet si i tillë në bazën ligjore të sipërpërmendur, por edhe sepse ekzistojnë prova të mjaftueshme, që e justifikojnë si të tillë.

¹⁸ *“Qëllimi i këtij ligji është të sigurojë të drejtën e çdo personi për: a) barazi përpara ligjit dhe mbrojtje të barabartë nga ligji; b) barazi të shanseve dhe mundësive për të ushtruar të drejtat, për të gëzuar liritë dhe të marrë pjesë në jetën publike; c) mbrojtje efektive nga diskriminimi dhe nga çdo formë sjelljeje që nxit diskriminim.”*

C. Lidhja e trajtimit të padrejtë, disfavorizues dhe të pabarabartë me “aftësinë e kufizuar”.

Konventa e OKB-së “Për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara”¹⁹ në mënyrë të posaçme në nenin 4/1, ka përcaktuar se: “Shtetet Palë marrin përsipër të sigurojnë dhe promovojnë realizimin e plotë të të gjitha të drejtave dhe lirive themelore të njeriut për të gjithë personat me aftësi të kufizuar pa diskriminim të ndonjë lloji me bazë aftësinë e kufizuar.”

Në frymën e Konventës, është miratuar, ligji nr. 93/2014 “Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara”, i cili ka si qëllim, të garantojë nxitjen dhe mbrojtjen e të drejtave të personave me aftësi të kufizuara për të mundësuar pjesëmarrjen e tyre të plotë dhe efektive në të gjitha sferat e shoqërisë, në kushte të barabarta me të tjerët, duke mundësuar autonominë dhe jetesën e pavarur për të gjithë personat me aftësi të kufizuara, nëpërmjet ofrimit të ndihmës e të mbështetjes; të përcaktojë përgjegjësinë e të gjitha strukturave publike dhe jopublike, përfshirë organet shtetërore, qendrore dhe vendore, në zbatimin e parimeve të përfshirjes dhe aksesueshmërisë për të zvogëluar, deri në heqje, pengesat për personat me aftësi të kufizuara, me qëllim mundësimin e pjesëmarrjes së tyre të barabartë në shoqëri.

Persona me aftësi të kufizuara, sipas këtij ligji, janë, personat që kanë dëmtime afatgjata fizike, mendore, intelektuale ose ndijore, dëmtime të cilat, në bashkëveprim me pengesat e ndryshme, përfshirë ato mjedisore dhe të qëndrimit, mund të pengojnë pjesëmarrjen e plotë dhe efikase të këtyre personave në shoqëri, në kushte të barabarta me të tjerët.

Jetesa e pavarur, u siguron personave me aftësi të kufizuara zgjedhje, kontroll dhe liri të njëjta me të tjerët. Ligji nr. 93/2014, përcakton se, një nga aspektet që siguron jetesën e pavarur për personat me aftësi të kufizuara është edhe transporti. Në gërmën “ë”, të pikës 2, të nenit 5, të ligjit nr. 93/2014, parashikohet se: “Politikat shtetërore mbështetin personat me aftësi të kufizuara që të kenë akses në të gjitha sferat e jetës e, ndër të tjera, të kenë akses përkatësisht:ë) në transport....”. Sipas nenit 6, të ligjit nr. 93/2014, jetesa e pavarur, mundësohet nëpërmjet shërbimeve të ndryshme që synojnë të ofrojnë mbështetje në kapërcimin e barrierave. Në këto shërbime përfshihen ndër të tjera edhe transporti.

Sikurse është përmendur edhe në rubrikat e sipërpërmendura, njësitë e qeverisjes vendore janë përgjegjëse për transportin urban qytetas. Në pikën 6, të nenit 23 “Funksionet e Bashkive në fushën e infrastrukturës dhe shërbimeve publike”, të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” parashikohet: “Në fushën e infrastrukturës dhe shërbimeve publike, bashkitë janë përgjegjëse në territorin e juridiksionit të tyre për:6. Transportin publik vendor”.

¹⁹Ratifikuar me ligjin nr. Nr. 108/2012 “Për Ratifikimin e Konventës së OKB-së “Për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara”.

Neni 26, i ligjit të sipërpërmendur, parashikon: “*Bashkitë janë përgjegjëse për kryerjen e këtyre funksioneve: 1. Krijimin dhe administrimin e shërbimeve sociale, në nivel vendor, për shtresat në nevojë, personat me aftësi të kufizuara, fëmijët, gratë, gratë kryefamiljare, gratë e dhunuara, viktima të trafikut, nëna apo prindër me shumë fëmijë, të moshuarit etj., sipas mënyrës së përcaktuar me ligj.*”

Nisur nga legjislacioni i sipërcituar Komisioneri vëren se Bashkia Kamëz ka dështuar në marrjen e masave për heqjen e të gjitha pengesave institucionale, për të krijuar të gjitha lehtësitë për garantimin e transportit qytetas për personat me aftësi të kufizuara, të verbër.

Parimi i ndarjes së barrës së provës është evidentuar tashmë në ligjin e BE dhe KEDNJ. KEDS²⁰ gjithashtu ka pranuar që në çështjet e diskriminimit, barra e provës nuk duhet të varet plotësisht nga ankuesi, por duhet të jetë objekt i një rregullimi të duhur.

Sa më sipër, ankuesi duhet të krijojë një prezumim të diskriminimit (diskriminimi *prima facie*), barra më pas kalon tek subjekti që pretendohet se ka kryer diskriminimin, i cili duhet të tregojë se ndryshimi në trajtim nuk është diskriminues. Kjo mund të bëhet:

1. Ose duke vërtetuar se nuk ka ndonjë lidhje shkakësore midis shkakut të mbrojtur dhe trajtimit të pafavorshëm apo të pabarabartë.
2. Ose duke provuar që megjithëse ky trajtim është i lidhur me shkakun e pretenduar, ka një justifikim të arsyeshëm dhe objektiv. Nëse subjekti që pretendohet se ka konsumuar sjelljen diskriminuese nuk është në gjendje të provojë njërin nga të dyja, atëherë do të jetë përgjegjëse për diskriminimin.²¹

Në rastin konkret, gjatë hetimit administrativ të kësaj çështjeje dhe provave të vëna në dispozicion nga palët, rezultoi se pavarësisht ekzistencës së legjislacionit të aplikueshëm dhe faktit që personat me aftësi të kufizuara, të verbërit, nuk kanë përfituar nga transporti urban në linjën e ofruar nga operatori Shpresa AL, nga ana e Bashkisë Kamëz nuk është vënë në dispozicion asnjë informacion apo provë lidhur me hapat e ndërmarrë për zgjidhjen e kësaj situate.

Në analizë sa më sipër, Komisioneri vlerëson se jemi para situatës së prezumimit të diskriminimit nga Bashkia Kamëz, kundrejt personave me aftësi të kufizuara, të verbër dhe si pasojë barra e provës bie mbi këtë subjekt. Në këto kushte, për të vërtetuar të kundërtën, Bashkia Kamëz duhet të përmbushë dy kushtet e përmendura më sipër.

Në analizë të fakteve dhe provave të administruara gjatë procedurës hetimore, rezultoi se:

²⁰ Komiteti Evropian për të Drejtat Sociale.

²¹ https://fra.europa.eu/sites/default/files/fra_uploads/fra-2018-handbook-non-discrimination-law-2018_en.pdf, fq.232.

- Bashkia Kamëz nuk rezulton të ketë kryer asnjë përpjekje me pushtetin qendror për t'i dhënë një zgjidhje përfundimtare situatës, në lidhje me përcaktimin e masave, kritereve dhe procedurat për kompesimin e tarifës së transportit qytetas për udhëtarët që përfitojnë lehtësi me ligje të veçanta.;
- Bashkia Kamëz ka pasur të gjithë mundësinë për zgjidhjen vetë të situatës konkrete, nisur nga fakti që transporti qytetas është funksion i saj, ekskluziv, për t'ia garantuar të gjithë banorëve të saj²², duke garantuar përkujdesje sociale të veçantë për personat me aftësi të kufizuar²³. Pikërisht në funksion të faktit, që transporti qytetas është funksion ekskluziv i Bashkisë, Ligji nr. 8308, datë 18.03.1998 “Për transportet rrugore”, i ndryshuar, në nenin 10, gërma c)²⁴, të tij parashikon edhe vendosjen e tarifës së shërbimit urban nga vetë Bashkia. Gjithashtu, neni 85, i ligjit nr. 8308, datë 18.03.1998 “Për transportet rrugore”, i ndryshuar, parashikon se fondet për kompensimin e transportit qytetas përballohen nga Bashkitë.

Njëkohësisht, vlen të theksohet fakti se dikur ka ekzistuar një ndarje diskriminuese në legjislacionin shqiptar, në lidhje me përfitimin e lehtësirave për përfitimin e shërbimeve, duke trajtuar ndryshe dhe në mënyrë të padrejtë, kategori të ndryshme PAK, në situata thelbësisht të ngjashme. Kjo problematikë është ndrequr me miratimin e Ligjit 93/2014 “Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuar”, i cili mbështetur edhe në Konventa e OKB-së “Për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara”, eliminon çfarëdolloj diferencimi në thelb të aftësisë së kufizuar dhe garantimit të lehtësirave për të gjithë personat me aftësi të kufizuar. Në këtë këndvështrim, diferencimi midis invalidëve të punës, të cilët sipas ligjit të posaçëm përfitojnë transport falas dhe personave të verbër, të cilët mararin kompensim, jo vetëm që është i padrejtë dhe diskriminues, por tashmë është i tejkaluar dhe të njëjtat garanci, që ofrohen për një kategori duhen garantuar edhe për kategoritë e tjera. Nisur nga fakti që ofrimi i shërbimit të transportit për personat me aftësi të kufizuar, realizohet në mënyrën më të plotë dhe të thjeshtë duke e garantuar atë falas, kjo duhet të ndodhë për të gjitha kategoritë e personave me aftësi të kufizuar, pa asnjë lloj dallimi apo diferencimi.

Për këtë arsye, mosnxjerrja e akteve nënligjore nga Këshilli i Ministrave, që në vetvete përbën një mosveprim shumë të rëndë, nuk mund të shërbejë si pengesë për Bashkinë Kamëz për zgjidhjen përfundimtare të situatës, pasi rendi juridik i ofron të gjitha mundësitë, që transportin falas, Bashkia mund dhe duhet ta garantojë vetë, si duke nxjerrë aktet e nevojshme normative, ashtu edhe duke bërë parashikimet për përfitimin e shërbimit falas për personat me aftësi të kufizuar. Lidhur me këtë, Bashkia në nenin 10 të kontratës së lidhur me operatorin e shërbimit Shpresa AL, ka cituar se: “Kontraktori merr përsipër të kryejë shërbimin e transportit në linjën

²² Në referencë të neneve 22 dhe 23, të Ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”.

²³ Në referencë të nenit 24, të Ligjit nr. 139/2015. “Për vetëqeverisjen vendore”.

²⁴ Neni 10, gërma c), i ligjit nr. 8308, datë 18.03.1998 “Për transportet rrugore” (i ndryshuar) parashikon: “Tarifat e biletave të transportit qytetas të udhëtarëve me autobus miratohen me vendim të këshillit të njësisë së qeverisjes vendore, sipas nenit 14 të këtij ligji.”.

përkatëse, të përmbushë detyrimin sipas nenit 8 dhe 9 të cituar më lart, kundrejt subvencionit të kontratës, vetëm pas miratimit në Këshillin Bashkiak të financimit të subvencioneve”.

Ndërkaq, nga analizimi i Kontratës së Shërbimit, që Bashkia Kamëz ka lidhur me operatorin e shërbimit urban qytetas, rezulton se në nenin 9 dhe 10, ka parashikime të sakta lidhur me detyrimin e operatorëve urban, për të ofruar transport falas për kategorinë e personave që përfitojnë lehtësira në udhëtim, si: udhëtimin pa pagesë kundrejt paraqitjes së dokumentit që parashikon ligji për to etj.

Komisioneri vlerëson se nga ana e Bashkisë Kamëz nuk u arrit të provohej:

1. Që nuk ka ndonjë lidhje shkakësore midis shkakut të pretenduar nga ankuesja, që është aftësia e kufizuar dhe trajtimit të pafavorshëm apo të pabarabartë nga ana e Bashkisë Kamëz, të konstatuar edhe nga Komisioneri në këtë vendim.
2. Që për veprimet dhe mosveprimet e këtyre subjekteve kundrejt ankueses dhe personave që ndodhen në kushte të njëjta me të, ka një justifikim të arsyeshëm dhe objektiv, pra që këto veprimeve dhe mosveprimeve ndiqnin një synim të ligjshëm dhe masat për arritjen e këtij synimi ishin proporcionale.

Gjatë shqyrtimit të kësaj ankese, Komisioneri konstatoi se Bashkia Kamëz nuk ka vepruar në bazë të kompetencave, që asaj i atribuohen nga aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi, për të ndaluar faktin e mos ofrimit të lehtësirave në transport për kategorinë e të verbërve, si dhe për rregullimin e situatës në mënyrë përfundimtare.

Për sa më sipër, Komisioneri vlerëson se kësaj kategorie personash me aftësi të kufizuara, sikurse edhe të gjitha kategorive të tjera që bëjnë pjesë në këtë grupim, u është mohuar një e drejtë, e cila u është dhënë nga legjislacioni në fuqi.

Në këto kushte, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, konstaton se Bashkia Kamëz, me anë të veprimeve dhe mosveprimeve të saj, ka vendosur përpara një situatë diskriminuese, për shkak të aftësisë së kufizuar, ankuesen dhe personat e verbër të përfaqësuar pranë Komisionerit nga Shoqata “Shpresë për të Verbërit”, sa i takon ofrimit të transportit pa pagesë të parashikuar në legjislacionin e sipërpërmendur.

Të njëjtin qëndrim, për një çështje të ngjashme ka mbajtur Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, kur me Vendimin Nr. 67, datë 10.06.2019²⁵, ka konstatuar diskriminimin e kategorisë së personave paraplegjikë dhe tetraplegjikë, nga ana e Bashkisë Shkodër, për shkak të aftësisë së kufizuar. Gjithashtu, Komisioneri me anë të shkresës Nr. 953 prot., datë 12.06.2019, i është drejtuar Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale dhe Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë me: “*Rekomandim mbi rishikimin/plotësimin e legjislacionit që*

²⁵ Ankesa Nr. 192, datë 18.12.2018, e Shoqatës Shkodrane të Invalidëve Paraplegjikë dhe Tetraplegjikë kundër Bashkisë Shkodër.

lidhet me lehtësirat në transport dhe përfitimin në baza të barabartë për të gjitha kategoritë e personave me aftësi të kufizuara”.

Bazuar në nenin 33, pika 10 të Ligjit “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, përcaktohet se: “Vendimi përmban rregullimet dhe masat e duhura, duke caktuar edhe një afat për kryerjen e tyre”, ndërsa bazuar në nenin 33, pika 12, përcaktohet: “Kur vendos masën, komisioneri siguron që ajo të jetë: a) e efektshme dhe parandaluese; dhe b) në përpjesëtim me gjendjen që e shkaktoi vendosjen e masës”

Ligji “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, në nenin 33/10 të tij, nuk ka përcaktuar masat që duhen marrë për rregullimin e situatës diskriminuese, por e ka lënë në diskrecionin e Komisionerit. Pra, Komisioneri rast pas rasti, vendos se cilat janë rregullimet dhe masat që duhen marrë në mënyrë që të sigurojë mbrojtjen efektive nga diskriminimi të personave që pretendojnë se janë viktima të diskriminimit. Ligji “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, nëpërmjet nenit 33/12, ka vendosur kriteret që duhet të ndjekë Komisioneri në përcaktimin e masës që ai jep nëpërmjet vendimeve të tij.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 32 dhe 33, të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Konstatimin e diskriminimit, për shkak të aftësisë së kufizuar, të kategorisë së personave të verbër, nga ana e Bashkisë Kamëz.
2. Në referencë të pikës 1 të këtij Vendimi, të merren masa të menjëherëshme nga ana e Bashkisë Kamëz, për të siguruar dhe garantuar lehtësitë në transport ndaj kësaj kategorie.
3. Rekomandohet që, Këshilli i Ministrave të marrë masa, për nxjerrjen e akteve nënligjore në zbatim të nenit 85, të Ligjit nr. 8308, datë 18.03.1998 “Për transportet rrugore” (i ndryshuar).
4. Rekomandohet që, Këshilli i Ministrave të marrë masa, për nxjerrjen e akteve nënligjore në zbatim të nenit 11, të Ligjit nr. 8098, datë 28.03.1996 “Për statusin e të verbërit” (i ndryshuar).
5. Rekomandohet që, Këshilli i Ministrave të marrë masa për ndryshimet në legjislacion dhe në aktet nënligjore, sipas nenit 20, të Ligjit nr. 93/2014 “Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuar”.

6. Brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga marrja dijëni për këtë Vendim, Bashkia Kamëz të njoftojë Komisionerin, lidhur me masat e marra për zbatimin e këtij vendimi.
7. Në referim të nenit 33, pika 11, të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010, “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, moszbatimi i këtij vendimi sjell si pasojë ndëshkimin me gjobë, sipas parashikimeve të pikës 13, të po këtij neni.
8. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijëni.

KOMISIONER

Robert GAJDA

(Shkaku: Aftësia e kufizuar)

(Fusha: Të mira dhe shërbime)